



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 194/2025

Datë: 14/04/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me në pajtim me nenin 10 (paragrafi 8 dhe 9) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar më Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin Nr. 08/L-272, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria në detyrë e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Refuzohet emërimi për noter i znj. Saranda (Xhevat) Rexhepi, noter në juridiksionin territorial të Komunës së Podujevës.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Znj. Saranda (Xhevat) Rexhepi e emëruar noter në juridiksionin territorial të Komunës së Podujevës me Vendimin nr. 234/2024, të datës 15.07.2024, ka aplikuar në konkursin publik për zgjedhjen e noterëve për pozita të lira për noterë të shpallur nga Ministria e Drejtësisë, më datë 17.12.2024. Znj. Saranda (Xhevat) Rexhepi aktualisht është e emëruar notere dhe me Vendimin Nr. 76/2025, të datës 26.03.2025 i është caktuar data për fillimin e ushtrimit të detyrës së noteres në territorin e komunës së Podujevës. E njëjta nuk e ka përfunduar mandatin, nuk është shkarkuar dhe nuk ka dhënë dorëheqje.

Ligji nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar më Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin Nr. 08/L-272 nuk parasheh procedurë të ri-aplikimit për personat që tashmë janë emëruar dhe ushtrojnë detyrën e noterit dhe për rrjedhojë aplikimi i Znj. Saranda (Xhevat) Rexhepi nuk ka bazë ligjore për t'u pranuar.

Andaj, bazuar në të lartpërmendurat dhe legjislacionin përkatës në fuqi, refuzohet emërimi i Znj. Saranda (Xhevat) Rexhepi si noter, pasi kërkesa e saj është e pabazuar.

Nga të cekurat më lartë, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

*Vendimi i dërgohet:*

- Znj. Saranda Rexhepi;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Odës së Noterëve të Kosovës;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.